



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI I PËRGJITHSHËM**

URDHËR

Nr. 1711 Prot.,

Nr. 227, datë 22.062026

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR KRYERJEN E PROCEDURËS SË INSPEKTIMIT ME MASË URGJENTE,
ME VENDIM TË NDËRMJETËM”**

Në mbështetje të shkronjës f, të nenit 13 dhe pikës 2, të nenit 46, të ligjit nr. 99, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores “Për kryerjen e procedurës së inspektimit me masë urgjente, me vendim të ndërmjetëm”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij Urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Njoftimin e inspektorateve qendrore, vendore dhe strukturave përgjegjëse sipas fushave të inspektimit si dhe publikimin në faqen zyrtare të Inspektoratit të Përgjithshëm www.ip.gov.al.
3. Ngarkohen inspektoratet qendrore, vendore si dhe strukturat përgjegjëse sipas fushave të inspektimit, për zbatimin e këtij urdhri.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

DASHNOR SULA



RREGULLORE PËR KRYERJEN E PROCEDURËS SË INSPEKTIMIT ME MASË URGJENTE, ME VENDIM TË NDËRMJETËM

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave për marrjen e masave urgjente me vendim të ndërmjetëm nga trupat inspektuese të inspektorateve qendrore, vendore dhe strukturave të tjera me funksione inspektimi gjatë procedurës së inspektimit, kur ekziston dyshimi i arsyeshëm për kanosje me rrezik apo rreziku është real dhe i dukshëm për shëndetin apo jetën e njerëzve dhe kafshëve, mjedisin, sigurinë publike, interesin e ligjshëm të personave fizik ose juridik apo interesin publik.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë:

- a) Rregullat për marrjen e masave urgjente me vendim të ndërmjetëm gjatë kryerjes së procedurës së inspektimit nga trupat inspektuese me qëllim parandalimin e pasojave që vijnë nga një rrethanë, fakt që përbën apo mund të përbëjë rrezik për shëndetin apo jetën e njerëzve dhe kafshëve, mjedisin, sigurinë publike, interesin e ligjshëm të personave fizik ose juridik apo interesin publik;
- b) Procedurën e ndjekur për marrjen, njoftimin, ekzekutimin, e vendimeve të ndërmjetme në rastet e jashtëzakonshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë së inspektimit;
- c) Procedurën e ankimimit administrativ ndaj vendimit të ndërmjetëm përfshirë edhe ankimimin gjyqësor, afatet e ndjekura të ankimit.

Neni 3 Baza ligjore

Kjo rregullore është nxjerë në bazë të shkronjës “f”, të pikës 1, të nenit 13, si dhe nenit 46 të ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar.

Neni 4 Terma dhe Përkufizime

1. **"Masa urgjente"** është një veprim administrativ i përkohshëm, që merret nga trupa inspektuese e inspektoratit qendror, vendor apo strukturat e tjera inspektuese gjatë kryerjes së procedurës së inspektimit, me qëllim parandalimin e një rreziku serioz, që mund të të shkaktojë dëm të menjëhershëm, të rëndë dhe të pariparueshëm për:
 - i. jetën ose shëndetin e njerëzve apo kafshëve,
 - ii. sigurinë publike,
 - iii. mjedisin,
 - iv. interesin publik,
 - v. interesin e ligjshëm të personave fizik ose juridik.
2. **"Dyshim i arsyeshëm"** nënkupton se dyshimi është i bazuar në të dhëna paraprake, tregues ose sjellje, apo indicie konkrete që e justifikojnë ndërhyrjen edhe kur nuk fakte të mjaftueshme, por ekziston dyshimi i i bazuar në prova, që shkelja mund të ekzistojë.
3. **"Dëm i menjëhershëm, i rëndë, i pariparueshëm"** nënkupton se pasojat janë të konsiderueshme, mund të ndodhin shpejt, dhe se nga mos marrja e masave të menjehershme mund të bëhet i pamundur rikthimi i situatës në gjëndjen e mëparshme.
4. **"Vendim i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente"** është akt administrativ individual me karakter të përkohshëm.
5. **"Inspektorat"** në kuptim të kësaj rregulloreje konsiderohet inspektorati qendror, inspektorati vendor, si dhe strukturat e tjera inspektuese, inspektorët e të cilëve kanë detyrimin e zbatimit të kësaj rregulloreje, nëse gjatë kryerjes së inspektimit gjinden në një nga rrethanat për të cilat është i detyruar të marrë masa urgjente sipas pikës 1 të nenit 4 të kësaj rregullore.

KREU II VENDIMI I NDËRMJETËM DHE MASAT URGJENTE

Neni 5 Marrja e masës urgjente

1. Gjatë zhvillimit të procedurës inspektuese, trupa inspektuese, me vendim të ndërmjetëm, mund të marrë masë urgjente kur:
 - a) nga shkelja e kërkesave ligjore mund të shkaktohet një dëm i menjëhershëm, i rëndë dhe i pariparueshëm i interesit publik apo i interesit të ligjshëm të personave fizik ose juridik, veçanërisht kur është e nevojshme për të shmangur një rrezik të menjëhershëm, të dukshëm për jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve apo mjedisin;
 - b) ekziston një dyshim i arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore, nga e cila mund të shkaktohet një dëm i menjëhershëm, i rëndë dhe i pariparueshëm, i interesit publik apo i interesit të ligjshëm të personave fizik ose juridik dhe është e nevojshme kryerja e verifikimeve të mëtejshme të dokumentacionit ose kryerja e ekzaminimeve apo analizave përkatëse.
2. Masat urgjente që trupa inspektuese mund të marrë me vendim të ndërmjetëm, janë si më poshtë vijon:
 - a) ndërprerja e një veprimi specifik, veprimtarie apo një pjese të saj;
 - b) ndalimi i funksionimit të një instalimi, makinerie apo pajisjeje;
 - c) bllokimi dhe ndalimi i hyrjes në pjesë të caktuara të ambienteve të ushtrimit të veprimtarisë;
 - ç) bllokimi dhe marrja në administrim e kafshëve, bimëve, mallrave, makinerive, produkteve apo sendeve;
 - d) ndalimi i përkohshëm i hyrjes në territorin e vendit të kafshëve, bimëve, mallrave, makinerive, produkteve apo sendeve;
 - e) urdhërimi i subjektit të inspektimit të njoftojë të tretët apo publikun për rreziqet e mundshme;
 - ë) çdo masë tjetër që vlerësohet e domosdoshme dhe proporcionale për të realizuar qëllimin e masës urgjente, parashikuar në legjislacionin e posaçëm sipas fushës ku kryhet inspektimi.
3. Para marrjes së masës urgjente, kur kushtet konkrete e lejojnë, inspektori njofton verbalisht përfaqësuesin e subjektit të inspektimit mbi qëllimin dhe arsyet e masës së parashikuar, duke i dhënë atij mundësinë të paraqesë menjëherë komentet, kontestimet apo shpjegimet përkatëse.
4. Gjetjet e konstatuara dhe masa urgjente mbahen në procesverbal, të nënshkruar nga trupa inspektuese dhe subjekti që inspektohet. Nëse subjekti refuzon të nënshkruajë, mbahet në procesverbal shënimi “refuzuar firma”, nënshkruar nga trupa inspektuese si dhe i lihet një kopje e procesverbalit subjektit. Nëse subjekti refuzon ta pranojë, trupa inspektuese ia dërgon procesverbalin në adresën zyrtare të postës fizike apo elektronike, brenda 24 orëve nga mbajtja e tij.
5. Vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente merret menjëherë, i cili duhet arsyetuar qartë, duke u pasqyruar faktet dhe shkeljet ligjore të cilët kanë çuar në marrjen e

masës urgjente dhe afati i përcaktuar në të. Ky vendim nënshkruhet nga trupa inspektuese që e mban atë.

6. Trupa inspektuese detyrohet të arsyetojë zgjedhjen e masës më pak kufizuese, duke u bazuar në parimin e proporcionalitetit të shkëljes së kryer me cënimin e interesit të ligjshëm apo sigurisë publike.

7. Trupa inspektuese, ka të drejtë të marrë njërën apo më shumë se njërën nga masat urgjente, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, sipas rastit, duke vlerësuar rrezikun dhe pasojën që ka ardhur apo mund të vijë nga rreziku. Gjithashtu, nëse rreziku është i lidhur, ka prekur apo mund të prekë publikun, trupa inspektuese, përveçse masës urgjente të marrë, urdhëron subjektin e inspektimit të njoftojë të tretët apo publikun për rreziqet e mundshme.

8. Në rastin e ndalimit të hyrjes në territorin e vendit, sipas shkronjës “dh” të pikës 2, të këtij neni, sendet depozitohen dhe ruhen sipas dispozitave të ligjit të posaçëm apo përkatësisht marrëveshjeve ndërkombëtare.

9. Inspektorati vendos shenjat dalluese të miratuara në rastet e bllokimit apo ndalimit.

10. Inspektorati urdhëron kryerjen e publikimit të vendimit të ndërmjetëm në faqen zyrtare të insitucionit apo/dhe në media, kur ka pasoja të konsiderueshme, apo nëse nga rrethana apo fakti i konstatuar është cënuar apo është vënë në rrezik jeta, shëndeti i njerëzve apo kafshëve, mjedisi, siguria publike, rendi ligjor.

KREU III

NJOFTIMI, EKZEKUTIMI DHE PËRFUNDIMI I MASËS URGJENTE

Neni 6

Njoftimi i vendimit të ndërmjetëm dhe ekzekutimi i tij

1. Vendimi i ndërmjetëm i njoftohet subjektit, menjëherë, si dhe nënshkruhet marrja dijeni nga subjekti. Nëse subjekti refuzon të nënshkruajë, mbahet shënimi “*refuzuar firma*”, nënshkruar nga trupa inspektuese si dhe i njoftohet subjektit jo më vonë se 24 orë në adresën zyrtare të postës fizike apo elektronike të tij.
2. Vendimi i ndërmjetëm për vendosjen e masës urgjente ekzekutohet menjëherë. Si fillim trupa inspektuese e njofton subjektin e inspektimit për ta ekzekutuar vullnetarisht. Në rast se subjekti i inspektimit nuk e ekzekuton vullnetarisht vendimin, ekzekutimi kryhet menjëherë nga organi i inspektimit përkatës, nëpërmjet trupës inspektuese. Gjithashtu, organi i inspektimit ndërhyt menjëherë për ekzekutimin e vendimit, nëse vihet në dijeni nga subjekti apo nga rrethanat e konstatuara rezulton se subjekti nuk do ta zbatojë vendimin.

3. Ekzekutimi kryhet me shpenzimet e subjektit të inspektimit. Shpenzimet e kryera për ekzekutimin e masës urgjente pasqyrohen në vendimin përfundimtar të inspektimit.

Neni 7

Rastet e përfundimtar të vendimit të ndërmjetëm

1. Vendimi i ndërmjetëm përfundon efektet e tij me kalimin e afatit të përcaktuar në të apo me largimin e shkakut për të cilin është marrë.
2. Vendimi i ndërmjetëm përfundon efektet e tij automatikisht në rastet e mëposhtme:
 - a) me njoftimin e vendimit përfundimtar, i cili nuk konstaton shkelje të kërkesave ligjore;
 - b) me përfundimin e procedurës administrative ose me mbarimin e afatit, brenda të cilit duhet të ishte dhënë vendimi përfundimtar.

Neni 8

Vendimi përfundimtar

Gjatë periudhës së kohëzgjatjes së vendimit të ndërmjetëm, trupa inspektuese verifikon nëse subjekti ka marrë masat për largimin e rrezikut brenda afatit të përcaktuar në vendim. Trupa inspektuese pas verifikimit, mer vendim përfundimtar për vazhdimin e efekteve të vendimit apo shfuqizimin e tij. Veprimet e trupës inspektuese mbahen në një procesverbal, për mbajtjen e të cilit do të zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 5 të kësaj rregullore.

Neni 9

Përfundimi i parakohshëm i masës urgjente

1. Subjekti i procedurës administrative të inspektimit mund të kërkojë me shkrim përfundimin e parakohshëm të masës urgjente kur pretendon se i ka përmbushur detyrimet përkatëse, nëpërmjet dokumentimit me prova dhe fakte.
2. Kërkesa shqyrtohet nga kryeinspektori, brenda 3 ditëve kalendarike nga paraqitja e saj. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, kryeinspektori vlerëson masat e ndërmarra nga subjekti bazuar në prova në raport me rrethanat që diktuan marrjen e masës urgjente nga trupa inspektuese. Kur nuk ka mjaftueshëm prova dhe fakte, urdhëron verifikimin në terren. Në çdo rast heqja apo lënia në fuqi e masës urgjente duhet të jetë e arsyetuar, e bazuar në ligj dhe në parimin e proporcionalitetit dhe vazhdimësisë së rrezikut.
3. Vendimi i cili lë në fuqi masën urgjente mund të ankimohet pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit në rrugë administrative si dhe gjyqësore në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin për inspektimet.

KREU IV

ANKIMI DHE SHQYRTIMI I VENDIMIT TË NDËRMJETËM

Neni 10

E drejta për ankim

1. Subjekti i inspektimit ka të drejtë të paraqesë ankim kundër vendimit për marrjen e masës urgjente bashkë me vendimin përfundimtar brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike, nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar.
2. Paraqitja e ankimit ndaj vendimit të ndërmjetëm nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të ndërmjetëm, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.
3. Kundër vendimit që vendos ndalimin e efektit pezullues mund të bëhet ankim i drejtpërdrejtë në gjykatën kompetente administrative, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

Neni 11

Përmbajtja e ankimit administrativ

1. Ankimi paraqitet nga përfaqësuesi i subjektit dhe duhet të përmbajë detyrimisht:
 - a) të dhënat identifikuese të subjektit ankues;
 - b) referencën e vendimit që kundërshtohet;
 - c) argumentet juridike dhe faktike mbi të cilat mbështetet ankimi;
 - ç) kërkesën konkrete të subjektit;
 - d) dokumente ose prova shoqëruese që mbështesin pretendimet e paraqitura.
3. Ankimi dhe dokumentacioni shoqërues pasqyrohen në sistemin unik të inspektimit “e-Inspektimi”, sipas procedurave të miratuara.

Neni 12

Organi kompetent për shqyrtimin e ankimit

1. Si rregull, ankimi kundër vendimit të ndërmjetëm shqyrtohet nga organi epror që është drejtuesi i drejtorisë rajonale ku është kryer inspektimi apo kryeinspektori i inspektoratit qendror në rastet kur inspektorati nuk ka drejtorin rajonale.
2. Në rastet e inspektimeve në juridiksionin e qeverisjes vendore, kur ligji i posaçëm nuk parashikon ndryshe, ankimi shqyrtohet nga kryeinspektori i inspektoratit vendor.

3. Organi epror ka të drejtë të zhvillojë hetime shtesë dhe të njoftojë për to pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe pretendimeve.

Neni 13

Vendimmarrja mbi ankimin

1. Organi epror në përfundim vendos një nga këto masa:
 - a) lënien në fuqi të masës urgjente;
 - b) ndryshimin e masës urgjente plotësisht duke vendosur një masë tjetër me të lehtë apo të rëndë ose pjesërisht;
 - c) shfuqizimin e plotë të vendimit të ndërmjetëm.
2. Vendimi për shqyrtimin e ankimit merret dhe i njoftohet subjektit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e ankimit nga paraqitja e ankimit.
3. Nëse organi kompetent nuk e ka shqyrtuar ankimin brenda afatit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, atëherë subjekti ka drejtën e ankimit ndaj mosveprimit administrativ të organit publik, tek organi epror i tij brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e përfundimit të afatit të ankimit. Organi epror, shqyrton mbi ankimin e subjektit dhe vendos në bazë të dosjes së çështjes apo, nëse është e nevojshme, zhvillon hetime administrative shtesë, apo urdhëron organin kompetent që të zhvillojë këto hetime shtesë dhe ta njoftojë për rezultatet e hetimit. Në përfundim organi epror zgjidh çështjen duke nxjerrë një akt përfundimtar, ndaj të cilit mund të ushtrohet e drejta e ankimit në gjykatë.
4. Vendimi pasqyrohet në sistemin “*e-Inspektimi*”.

Neni 14

Ankimi në gjykatë

1. Kundër vendimit përfundimtar, subjekti ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
2. Në rast se organi epror më i lartë nuk vepron sipas pikës 3 të nenit 13, atëherë subjektit i lind e drejta e ankimit në gjykatën administrative kompetente për shkak të cënimit të së drejtës ndaj mosveprimit të organit publik, në përputhje me ligjin 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 15

Dispozita të fundit

1. Inspektoratet qendrore, vendore, si dhe çdo strukturë tjetër me funksione inspektimi, janë përgjegjëse për zbatimin e këtyre rregullave.
2. Formatet standarde të akteve, sipas të cilave do të kryhet procedura e marrjes së vendimit të ndërmjetëm si dhe aktet e tjera për zbatimin e kësaj rregulloreje miratohen me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm.